



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA ROSKOVEC**

Adresa, Lagja nr.1 Roskovec, web:www.bashkiaroskovec.gov.al, nr.tel : 0387 80242

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE**  
**PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL**  
**NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**(Specialist)**

**Lloji i diplomës “Drejtësi, Ekonomi, Finance”**  
**Niveli minimal i diplomës “Diplome e Nivelit te Pare”**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave (I ndryshuar), **Bashkia Roskovec** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

❖ **2 (dy) specialist të Auditit të Brendshëm, Bashkia Roskovec**

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtes kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil. Nëse nuk ka një fitues nga procedura e lëvizjes paralele, plotësimi i vendit vakant do të realizohet me procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Pranimi në Shërbimin Civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- **Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**LEVIZJE PARALELE: 04.10.2019**

- **Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 09.10.2019**

**Përshkrim i Përgjithshëm:**

*Auditimi i brendshëm”, është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës. Ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat e vet, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësisë publike.*

## **DETYRAT**

### **Detyrat Kryesore**

- *Mbështet njësinë publike për të arritur qëllimet e saj, duke:*
  - o *ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në njësinë publike;*
- *Vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave e kontrolleve;*
- *Mbështet njësitë publike në menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollit, në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:*
- *identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;*
  - o *përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin; besueshmërinë dhe gjithë-përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional.*
- *Ruajtjen e asetëve dhe të informacionit;*
- *Përbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;*
- *Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarive të njësive publike.*
- *Mbështetjen e angazhimeve/kryerja e detyrave të veçanta të auditimit për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të konsulencës;*
- *Dhënien e vlerësimeve objektive, opinioneve ose përfundimeve të pavarura për një proces, sistem ose një çështje tjetër që mbulohet nga auditimi.*
- *Të respektojë në çdo rast dhe rrethanë gjatë kryerjes së detyrës kodin etiko-moral të nëpunësit civil dhe kodin etiko-moral të audituesit.*
- *Të njihet me të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me veprimtarinë a çështjen që do të auditohet.*
- *Të marrë nga personat zyrtarë dhe punonjësit e tjerë të dhëna të domosdoshme me shkrim dhe me gojë që lidhen me kryerjen e auditimit ekonomiko-financiar.*
- *Të vulosë arka dhe agjensi, depo e magazina, në raste të domosdoshme e kur ka të dhëna për falsifikime ose veprimtari të tjera të paligjshme, të tërheqë dokumentat e nevojshme, duke lëshuar vërtetimin përkatës.*

- Të pezullojë veprimet e paligjshme, deri në shqyrtimin nga organi më i lartë nga varet subjekti i audituar.
- Të mbajë procesverbal, aktverifikim, sipas rregullave të përcaktuara në aktet ligjore për këtë fushë, duke njoftuar në moment eprorët.
- Të propozojë masa disiplinore, gjopa, ndjekje penale sipas rastit që paraqitet.
- Të përgatisë të gjitha dokumentat që duhen konform standarteve dhe metodikave në fuqi të auditimit, për evadimin dhe plotësimin e dosjes së cdo auditimi të kryer, dorëzimin e saj në përfundim sipas rregullave të miratuara në arkivën Njesisë së Auditimit të Brendshëm

## I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

**Kushtet minimale** që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicion janë:

- a) Te zoterojë diplome minimumi 3-vjecare, Diplomë “Bachelor” “ Drejtesi, Ekonomi, Finance”. Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi,
- b) Te kete te pakten 1 vit punë,
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidati duhet të dërgojë **me postë ose dorazi në një zarf** të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerezore të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
10. Vërtetim të gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore. (Dëshmi penaliteti dhe raport mjekesor).

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **04.10.2019**.

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së levizjes paralele dhe të permbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datën **07.10.2019**. Nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Sherbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë dhe në standin e informimit të publikut portalin "Sherbimi Kombëtar i Punësimit",

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkak të moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësine përgjegjëse të menaxhimit të Burimeve Njërëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimeve.

Pas përfundimit të procedurës së sipërpermendur nepunësi me i lartë civil i institucionit brenda dy ditëve kalendarike urdheron ngritjen e komisionit të brendshëm.

Komisioni i brendshëm brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e krijimit të tij, zhvillon intervistën me gojë.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec më datë **17.10.2019 ora 11:00**.

#### **Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

1. Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik për Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar me ligjin nr. 10318 datë 16.09.2010;
2. Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar."
3. Ligji Nr. 10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë"
4. Ligji Nr. 10297, datë 08.07.2010 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar"
5. Ligji Nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për Inspektimin financiar publik."
6. Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin."
7. Ligji Nr. 10 433 datë 16.6.2011 për "Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkinë Roskovec**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë:
- b. 20 pikë për përvojën,
- c. 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv;
- d. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara dhe i dërgon listën njësise së burimeve njërëzore të institucionit. Njësia e burimeve njërëzore e

institucionit, brenda 24 oreve nga dita qe komisioni i njofton vendimin e tij, njofton individualisht kandidatet qe kane konkuruar per rezultatin e tyre. Kandidatet, pavarsisht nga e drejta per tu ankuar kane te drejte te bejne ankim me shkrim dhe ne komisionin e brendshem per levizjen paralele per rezultatin e vleresimit, brenda 3 (tre) diteve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankueset merr pergjigje brenda 3 (tre) diteve kalendarike nga data e perfundimit te afatit.

Komisioni më **date 23.10.2019** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, me date **28.10.2019** shpall fituesin.

#### **Njoftimi do të bëhet:**

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkise Roskovec
- stenden e publikimeve te Bashkisë Roskovec.

## **II- Pranimi në Shërbimin Civil.**

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

### **Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta**

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar (hequr) sipas këtij ligji.

### **Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:**

Te zoteroje diplome 3-vjecare, “Bachelor” ne deget :” *Drejtësi, Ekonomi Finance, Biznes, Kontabilitet, Finance-Banke*”. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorise Juridike dhe Burimeve Njerezore, të Bashkisë Roskovec këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetësore.

### **Afati i fundit i pranimit te kandidatëve do te jete data 09.10.2019**

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures e pranimit në shërbimin civil dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **19.10.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, ne portalin "Sherbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore brenda 5 diteve kalendarike nga dhe ankuesi merr pergjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e perfundimit e afatit te ankimit.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me goje, do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec më datë **05.11.2019 ora 10:00.**

**Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me goje, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

1. Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik për Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 10318 date 16.09.2010;
2. Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar."
3. Ligji Nr. 10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë"
4. Ligji Nr. 10297, datë 08.07.2010 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar"
5. Ligji Nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për Inspektimin financiar publik.
6. Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
7. Ligji Nr. 10 433 datë 16.6.2011 për "Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkise Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidatëve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;

- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin “*Specialist i Auditit të Brendshëm*”.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimi brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më **date 06.11.2019** I ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, me **date 19.11.2019** shpall listen e fituesve.

**Njoftimi do të bëhet:**

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik te Bashkise Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : *oltaristani@yahoo.com*

nr.tel: **0387 80242.**

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE**

**BASHKIA ROSKOVEC**